



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 59762021  
Data: 16.08.2021

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e shtatë -VII- për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 21.07.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetarë i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet e Financa), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Edon Curi (Drejtor për Administratë), Sevime Laçi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Ilir Kaloshi (Përfaqësues nga N.P.L “Pastrimi” sh.a). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2021.
3. Raporti i auditorit të brendshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2020.
4. Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit të brendshëm - 2020.
5. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.
6. Informatë për raportin e përmbushjes së planit të integritetit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.
7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021.
8. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**



## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## 2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2021.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2021 është në lartësi prej 2,520,165.91 €. Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim: Paga dhe shtesa 1,602,780.91 €, Mallra dhe shërbime 335,258.00 €, Shërbime komunale 67,000.00 €, Subvencione dhe transfere 75,000.00 €, Shpenzime kapitale 385,127.00 €, Rezervat 55,000.00 €. Totali i buxhetit 2,520,165.91 €. Buxheti përfundimtar është në shumë prej 2,684,502.11 €, që dmth, kemi pasur një rritje prej 164,336.20 € duke përfshirë: Bartjen e mjeteve nga donacionet e pashpenzuara të vitit 2020 nga Bashkimi Evropian në shumë prej 24,696.82 €. Bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2020 në vitin vijues 2021 në shumë prej 57,779.88 €. Bazuar në vendimet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, janë ndarë mjete shtesë për betejën kundër pandemisë COVID-19 në shumë prej 40,172.50 € për shtesat mujore mbi pagën bazë në kategorinë paga dhe shtesa në sektorin e kujdesit primar shëndetësor për muajt janar-maj 2021, në sektorin e arsimit për muajin shkurt 2021, në sektorin e zjarfikësve për muajt shkurt dhe mars 2021 dhe sektorin social për muajt shkurt dhe mars 2021. Donacion nga DEMOS për shkak të performancës komunale, në shumë prej 41,687.00 €, për projektin "Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit". Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar - qershor 2021 është në shumë prej 1,181,335.29 € apo 44.01%. Prej tyre shpenzimi sipas kategorive është si vijon: Paga dhe shtesa në shumë prej 810,386.79 € apo 49.10 %, Mallra dhe shërbime në shumë prej 157,735.16 € apo 44.66 %, Shërbime komunale në shumë prej 25,274.42 € apo 37.72 %, Subvencione dhe transfere në shumë prej 33,885.00 € apo 42.20%, Shpenzime kapitale në shumë prej 154,053.92 € apo 32.19 % dhe Rezervat në shumë prej 0.00 €. Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2021 është në shumë prej 288,624.00 €. Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtoj gjithsejtë 192,512.10 € të hyra vetanake për periudhën janar-qershor 2021 apo 66.70% e planit të të hyrave vetanake, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 kemi një rritje prej 63,395.90 € më shumë apo 49.10%. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- a mund të specifikohen mëditje më në detale apo është te shtesat të cilat janë dhënë në kohën e pandemisë.

**Shabi Rexhallari** thekson:- përveç këtyre që janë paraqitur diçka tjetër nuk ka.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U VOTUA RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

## 3. Raporti i auditorit të brendshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2020.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- departamenti nga ministria e financave e ka bërë një raport të auditimit që ka të bëjë për periudhën 2020 dhe për periudhën janar-mars 2021. Në bazë të këtij raporti që është bërë del që kemi vetëm një rekomandim . Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.



**Mehmet Ballazhi** thekson:- a përfshihet në këtë raport diçka për përmirësimin e gjashtë rekomandimeve të cilat kanë qenë.

**Shabi Rexhallari** thekson:- në faqe 15 është lidhur aneksi, që ishin katër rekomandime dhe nga ato katër rekomandime dy janë të zbatuara, një është i pazbatuar dhe një është në proces.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA RAPORTI I AUDITORIT TË BRENDSHËM PËR KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **4. Plani i Veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit të brendshëm - 2020.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- në momentin që janë dhënë rekomandimet është dashur me bërë veprimin e menaxhmentit dhe janë caktuar datat se kur ka me përfunduar ky rekomandim nga përgjegjësit të cilët janë për me zbatuar këtë rekomandim.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- te plani i veprimit a keni ndonjë plan detal apo vetëm këtë të cilin e keni paraqitur këtu.

**Shabi Rexhallari** thekson:- hapi parë është formimi i komisionit për monitorimin e subvencioneve. OJQ të cilat do të financohen do të ju përcaktohet një afat deri në gjashtë muaj për me njoftuar komunën për mjetet që i ka shpenzuar dhe pastaj do të bëhet monitorimi i tyre.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA PLANI I VEPRIMIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË RAPORTIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM -2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

#### **5. Themelimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.**

**Kryesuesi** thekson:- në grup punues çdo herë është përfshirë Komiteti për Politik e Financa dhe jam i pajtimit që edhe në këtë vit me vepruar siç kemi vepruar në vitet e kaluara, mirëpo do ta diskutojmë në kuvend nëse është e nevojshme me u përfshirë edhe z.Mefail Suma nga subjekti politik Nisma për Kosovë . Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- është mirë që të përfshihet edhe z. Mefail Suma nga subjekti politik Nisma për Kosovë dhe z.Sead Vila që është anëtarë i pavarur në asamblenë komunale.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA THEMELIMI I GRUPIT PUNUESË PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**



**6. Informatë për raportin e përmbushjes së planit të integritetit të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2020.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Edon Curri** thekson:- plani i integritetit është miratuar në kuvend në fund të viti 2019 dhe në bazë të planit drejtoria është e obliguar me raportuar dy herë në vit në lidhje me këtë plan. Grupi punues e ka hartuar këtë raport dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA INFORMATATA PËR RAPORTIMIN E PËRMBUSHJES SË PLANIT TË INTEGRITETIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

**7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2021.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- këshilli komunal për siguri në bashkësi për çdo muaj ka mbajtur takimet e planifikuara në të cilën kryesisht diskutohen temat për sigurinë e komunës. Është diskutuar çështja e sigurisë për të cilën raportojnë organet e sigurisë. Është diskutuar çështja e pandemisë dhe problemet të cilat e kanë përshkruar çështjen e pandemisë. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- problemin te kufiri nuk di a keni diskutuar apo jo se shpesh herë po bëhet problematike. A është menduar ndonjë alternativ aty që së paku deri sa të bëhet zgjidhja për atë pjesë . Te rrethi që është te autostrada po grumbullohen shumë qenët endacak dhe pavarësisht që ligji nuk na lejon, duhet me ndërmarr diçka sepse në atë pjesë ka lëvizje të shpeshta të qytetarëve.

**Teuta Shkreta** thekson:- për çështjen e rrahjeve që kanë ndodhur te shkolla a është diskutuar kjo çështje me këshillin e prindërve për shkak se çdo herë po janë të njëjtit që po rrahën.

**Mallzum Qajani** thekson:- tema që më së shumti po diskutohet është qarkullimi te kufiri. Disa herë kemi kërkuar nga policia që me mbajtur rendin por stacioni policorë ka deklaruar që nuk ka personel për me mbajtur. Është zotuar niveli rajonal që do të merret me atë çështje. Kryetari i komunës ka pasur takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës që planifikohet të krijohet një shirit te kufiri por në detale diçka nuk kemi. Çështjen e qenve endacak e kemi diskutuar por nuk kemi mundur me ndërmarr diçka për shkak të ligjit por janë disa OJQ të ndryshme që i marrin në strehim qentë endacak mirëpo qëndrimi ditorë është 25 € për në qen dhe komuna nuk ka mundësi buxhetore , por seriozisht është problem i madh çështja e qenve endacak.

**Menduh Vlashi** thekson:- janë marr gjitha masat për rastin rrahjes së nxënësve që kanë ndodhë. Janë procedurë gjygsore por ngjarja ka ndodhur jashtë objektit shkollorë dhe është në procedurë të rregullt gjygsore.



**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA INFORMATA PËR AKTIVITET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **8. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2021 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Illir Kaloshi** thekson:-përveç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- punëtori i cili ka bërë pastrimin e Varrezave të Dëshmorëve a është larguar apo e ka lënë punë për shkak se tash kompania është duke e bërë mirëmbajtjen e varrezave. Kanë qenë dy kontinier të mëdhenj për mbeturina por ka mbetur një dhe është mirë të jenë dy në mënyrë që mos me u ndotur ajo pjesë.

**Refet Kalisi** thekson:- punëtori i cili e ka bërë mirëmbajtjen e varrezave në fund të muajit qershor i ka skaduar kontrata por është larguar me vetë dëshirë për shkak se ka kërkuar pagë shtesë sepse nuk ka qenë i kënaqur me pagën të cilën e ka marr. Mirëmbajtja e varrezave është në kuadër të N.P.L “Pastrimi” sh.a. I kam rekomanduar kompanisë që me vendosur edhe një kontinier.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTUA RAPORTI FINACIAR PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2021 I N.P.L PASTRIMI SH.A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **9. Të ndryshme.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- çështja te kufiri që po kalojmë është problem më seriozë që po mendojnë me bërë zgjidhjen e asaj rruge por së paku policia me u fokusuar që me mbajtur pikën e hapur për me kaluar veturat të cilat shkojnë në drejtim të fshatrave për shkak se po bëhen ndeshje dhe po ka probleme në mes të personave të ndryshëm.

**Mallzum Qajani** thekson:- buxheti i komunës nuk është i fuqishëm për me zgjedhur problemin e qarkullimit te kufiri sepse në qoftë se shtohet sasia e rrugës patjetër duhet të bëhet eksproprijimi i tokës dhe ne e dimi çmimin e tokës te kufiri që do të thotë komuna nuk ka mjete financiare për me bërë një gjë të tillë. Është e vizatuar shenja që në atë pjesë mos me hyjë veturat por nuk respektohet dhe po ashtu është shenja e ndalim parkimit për rreth rrugës dhe kemi kërkuar nga policia që me vepruar për shkak se shenjat janë. Si komunë jemi të shqetësuar shumë për këtë çështje për shkak se qytetarët në shpi të vetë me shkuar po vonohen deri në tridhjetë minuta.

**Kryesuesi** thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 11:44

**Procesmbajtësi**  
**Avni Bushi**

